

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: KALIMI I FIDERIT C6 20KV, N/STACIONI
TRAKTORA 110/20/6KV, NGA LINJË AJRORE NË
KABLLORE**

HYRJE

Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit të rrjetave elektrike që ka kompania OSSH-se, ndër të tjera është dhe eliminimi i rrjetit ajror TM në zonat me intensitet të lartë urban të qytetit Tirane.

Në vitet e fundit në sistemin e Shpërndarjes janë kryer investime domethënëse, në pajtueshmëri me objektivat dhe synimet e identifikuara nga planifikimi afatgjatë të rrjetit elektrik.

Nisur nga sa më lart si dhe duke u mbështetur në kërkesat e njësive mbi problematikat që hasen më shpesh në rrjet, si pasojë e defekteve në linjë, lind nevoja për përmirësimin dhe ndërhyrjet në zonat ku shfaqen këto problematika.

Konkretisht në këtë relacion do të shqyrtojmë kalimin e një segmenti të fiderit C6 N/Stacioni Traktora nga linje ajrore në kabllorë. Linja e re TM do të shtrihet përgjatë rrugëve “Unaza e Madhe Shkoze”, “Agush Gjergjevica”, “Rruga e Mumajeseve”, “Pasho Hysi” dhe “Idriz Dollaku”.

Objektivat specifike kanë të bëjnë me:

- ❖ Eliminimin e rrjetit ajror që është jashtë kushteve teknike.
- ❖ Eliminimin e rrjetit ajror në zonat ku ka intensitet zhvillimi urban.
- ❖ Zhvillimin e rrjetit kabllor të Shpërndarjes TM 20 kV duke respektuar standarte konform kushteve teknike.
- ❖ Zvogëlimi i humbjeve teknike në nivelin e lejuar sipas standardeve teknike
- ❖ Rritja e cilësisë së furnizimit për abonentet fundorë, duke ulur kohën e ndërprerjes dhe pasjen e një tensioni të stabilizuar.

GJENDJA EKZISTUESE E RRJETIT

Rrjeti ekzistues TM qe kalon ne kete zone eshte aktualisht ajror dhe nuk i pergjigjet ritmit dhe zhvillimit urbanistik, pasi paraqitet jashte kushteve teknike , gje qe sjell kufizime dhe cilesi te ulet ne furnizimin me energji elektrike te abonenteve .

Projekti ka per qellim permiresimin e problemeve te infrastruktures elektrike ekzistuese ,qe duhen bere ne kabinat elektrike ekzistuese ne pronesi te OSSH-se dhe ato private popullate, me rrjetin e Shperndarjes TM dhe TU,me qëllim të integritimit në rrjetin me standartet me te larta ,duke rritur sigurine dhe cilesine e kabinave elektrike si dhe te rrjetit TM/TU te tyre.



Fiderat ajrore te N/St Traktora 110/20/6kV.

OËLLIMI

Ky projekt ka për qëllim zëvendësimin e rrjetit aktual ajror 20 kV me rrjet të ri kabllor 20kV, për t'iu përgjigjur në kohë zhvillimin urbanistik dhe demografik të zonës që do të mbulojë ky projekt, Projekti parashikon të realizoje rikonstruksionin e rrjetit TM/TU ajrore të kabinave ekzistuese dhe shtimin e kabinave të reja. Disa kabina shtyllore do të demontohen dhe do të zëvendësohen me kabina të reja tip box.



Kabina ekzistuese “Kryegjyshata 3”, fideri Fideri C6 (20kV), N/St Traktora

Konkretisht:

- Linja e re kabllore fillon nga Nenstacioni Traktora deri ne kabinen “Idriz Dollaku 2A” ne zonen Ali Demi,me nje gjatesi prej 6000 m ,duke eleminuar gjithe pjesen ajore te fiderit C6.
- Kabina e pare qe do te lidhet ne linjen e re kabllore ,eshte kabina ekzistuese box “K1” me TR 400kva dhe me pas kabina ekzistuese box “Kryegjyshata 3” TR 400kVA
- Do te shtohen 2 kabina te reja tip mini box “K2” me TR 400kVA te ri dhe “ Box Anxhelo Kazo” me TR ekzistues 100kVA,duke eleminuar 5 kabina shtyllore “Private familjare Xhajat”,”Shtyllore Mmajes”,”Private Pasho Hyso”,”Private A.Sinani” dhe “Shtyllore Anxhelo Kazo “.
- Kabinat e reja box qe do vendosen do te furnizojne rreth 220 abonente te zones,qe merrnin furnizim nga rrjeti i vjeter ajror.
- Ne kabinen ekzistuese box “Burgu 325” do te realizohet lidhja ne unaze e Fiderit C6 me Fiderin C3 N/St Traktora.Per te mundesuar furnizimin e dyte me energji te Burgut te Grave,ne kabinen “Idriz Dollaku 1” fideri C3,do te shtohet nje cele e re linje.



Kabina ekzistuese “Idriz Dollaku 2A”, fideri Fideri C6 (20kV), N/St Traktora



Kabina Shtylllore “Anxhelo Kazo”, fideri Fideri C6 (20kV), N/St Traktora

**MBROJTA DHE SIGURIA E PUNONJËSVE OË DO
KRYEJNË PUNIMET.**

Të gjithë punonjësit që do të jenë pjesë e punimeve të zbatimit, duhet të jenë të pajisur me formimin e duhur, për marrjen e masave paraprake të sigurisë në punë, përfshirë dhe masat e nevojshme për të parandaluar rreziqet për njerëzit e tjerë dhe objekteve të tjera.

Për të gjithë punonjësit që do të kryejnë punime pranë paisjeve apo linjave elektrike me dhe pa tension duhet të jenë të pajisur me veshjet, mjetet dhe veglat e nevojshme si dhe me kategoritë përkatëse të njohjes dhe zbatimit të rregullores dhe shfrytëzimit teknik.

Të gjithë punonjësit të jenë të pajisur me grupin e kualifikimit të dhënë nga Inspektoriati Qëndror i Sigurimit Teknik për vitin aktual

